



AXHENDA

Konferenca e 7-të e OSBE-së për Median në Evropën Juglindore

Kufiri i Ri:

Punojmë së Bashku Për Të Nxitur Lirinë e Medias

Dita 1: Siguria e Gazetarëve

09:15 Pjesëmarrësit lidhen online me platformën ZOOM (linku do t'u shpërndahet pjesëmarrësve)
Moderator i Konferencës: Adis Mustedanagić, Zyra e Përfaqësuesit të OSBE-së për Lirinë e Medias

09:30 Fjala e mirëseardhjes

- **Jürgen Heissel**, Drejtor, Zyra e Përfaqësuesit të OSBE-së për Lirinë e Medias
- **Inid Milo**, Kryetar, TASK FORCA e Kryesisë së OSBE-së, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- **SH.T. Andrea Orizio**, Kryetar i Misionit të OSBE-së në Serbi

10:00 Fjalim: Promovimi i Lirisë së Medias: Fokusi te Ballkani Perëndimor

- **Patrick Penninckx**, Shef i Departamentit për Shoqërinë e Informacionit, Këshilli i Evropës

10:15 Sesion Paneli I: Mundësitë dhe Sfidat në Ngritjen e një Mekanizmi Kombëtar Efikas për Mbrojtjen e Gazetarëve – Grupet e Punës për Mbrojtjen e Gazetarëve në Serbi dhe Holandë

Mungesa në rritje e sigurisë së gazetarëve ka qenë një nga shqetësimet më akute dhe të përhapura në rajon. Në dhjetor 2016, Ministria e Brendshme e Serbisë, Prokuroria e Republikës dhe shtatë shoqata të medias dhe gazetarëve nënshkruan Marrëveshjen për bashkëpunim dhe masa për rritjen e nivelit të sigurisë së gazetarëve. Në janar 2017, u ngrit Grupi i Përhershëm i Punës për Sigurinë e Gazetarëve i përbërë nga përfaqësues nga të gjithë nënshkruesit. Përveç themelimit të Grupit të Punës, Marrëveshja parashikonte edhe ngritjen e një Sistemi Personash Kontakti si një mekanizëm tërësisht i ri për reagim urgjent dhe përgjigje të koordinuar për rastet e sulmeve ndaj gazetarëve.

Në korrik 2018, autoritetet ligjzbatuese holandeze dhe komuniteti i medias arritën një Marrëveshje për t'iu kundërvënë bashkërisht dhunës dhe kërcënimeve ndaj gazetarëve. Këto nisma janë shembuj se si dialogu konstruktiv ku përfshihen palët e interesuara çon në hapa të qenësishëm përpara në krijimin e kushteve të nevojshme për përmirësimin e sigurisë së gazetarëve. Sidoqoftë, qëkëto procese komplekse të jenë efektive, nevojitet kohë, nxenie evazhdueshme dhe mirëkuptim i ndërsjellë mes të gjitha palëve të përfshira. Ky sesion paneli fokusohet te mundësitë dhe sfidat me të cilat përballen të dy grupet e punës në përpjekjet e tyre për të adresuar pandëshkueshmërinë në rritje lidhur me sulmet ndaj gazetarëve.

- **Branko Stamenković**, Zv. Prokuror i Përgjithshëm i Republikës së Serbisë dhe anëtar i Grupit të Përhershëm të Punës për Sigurinë e Gazetarëve
- **Peter ter Velde**, Koordinator i Sigurisë për Korporatën Holandeze të Transmetimeve (NOS) dhe i Sigurisë së Shtypit, PersVeilig
- **Toni Angelovski**, Zv. Ministër për Marrëdhëniet me Publikun, Ministria e Brendshme, Maqedonia e Veriut
- **Moderator: Gordana Janković**, Shefe e Departamentit të Medias, Misioni i OSBE-së në Serbi

11:45 Pushim për kafe: Shfaqja e videove me histori nga gazetarët vendorë, përgatitur nga Fondacioni Slavko Čuruvija

12:15 **Sesion Paneli II: Unifikimi i Databazave Kombëtare, Analizimi dhe Raportimi i Sulmeve dhe Dhunës ndaj Gazetarëve**

Vendimi i Këshillit Ministror të OSBE-së për Sigurinë e Gazetarëve (nr. 3/18) kërkon që Shtetet pjesëmarrëse "të krijojnë ose të forcojnë, sipas rastit, mbledhjen e të dhënave kombëtare, analizimin dhe raportimin e sulmeve dhe dhunës ndaj gazetarëve". Që nga miratimi i këtij dokumenti, disa Shtete pjesëmarrëse kanë ndërmarrë nisur të ndryshme me qëllim krijimin e databazave ndërkombëtare që garantojnë informacion më të saktë dhe të besueshëm rreth natyrës dhe shkallës së shkeljeve të lirisë së medias.

Ky sesion paneli shërben si platformë diskutimi mbi praktikat aktuale rajonale dhe shembujt e suksesshëm për ngritjen e mekanizmave efikasë për dokumentimin nga ana e autoriteteve ligjzbatuese dhe shoqatave të gazetarëve të sulmeve dhe formave të tjera të dhunës ndaj gazetarëve. Databazat e krijuara prej shoqatave të gazetarëve shpesh ofrojnë shifra të ndryshme për sulmet e regjistruara ndaj gazetarëve, krahasuar me ato të policisë apo prokurorisë. Kjo situatë ndërlikon më tej përpjekjet e përbashkëta që synojnë t'i kundërvihen pandëshkueshmërisë për krimet ndaj gazetarëve dhe profesionistëve të tjerë të medias.

- **Snezana Trpevska**, Kryetare, Instituti Kërkimor për Zhvillim Social, Maqedonia e Veriut
- **Sanela Gorušanović-Butigan**, Zv.Kryetare, Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe i Prokurorisë i Bosnjë-Hercegovinës
- **Ardi Veliu**, Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit
- **Ana Bošković**, Prokurore Shteti në Prokurorinë Shtetërore të Basicit, Mali i Zi
- **Moderator: Ton Van Den Brandt**, Këshilltar i Lartë, Zyra e Përfaqësuesit të OSBE-së për Lirinë e Medias

13:30 **Mbyllet Dita I**

Dita 2: Gazetaria në epokën e COVID-19

09:15 **Pjesëmarrësit lidhen online me platformën ZOOM (linku do t'u shpërndahet pjesëmarrësve)**

09:30 **Fjala e mirëseardhjes**

- **SH.T. Sem Fabrizi**, Kreu i Delegacionit të BE-së në Serbi
- **SH.T. Jørn Eugene Gjølstad**, Ambasador i Mbretërisë së Norvegjisë në Serbi

10:00 **Fjalim: COVID-19 dhe media: Roli i Gazetarisë në një Pandemi Globale**

- **Guy Berger**, Drejtor për Strategjitë dhe Politikën në fushën e Komunikimit dhe Informimit, UNESCO

10:15 **Sesion Paneli III: Ndikimi i COVID-19 te Liria e Medias në Ballkanin Perëndimor**

Gazetaria luan rol të domosdoshëm në kohë emergjencash të shëndetit publik, si në rastin e pandemisë aktuale të COVID-19, sidomos kur synon t'i përcjellë publikut informacione thelbësore dhe të monitorojë masat e qeverisë. Në këtë sesion paneli, ekspertë të ndryshëm nga rajoni do të diskutojnë nëse është ndikuar liria e medias në Ballkanin Perëndimor nga masat lidhur me COVID-19, me fokus të veçantë te mësimet e nxjerra që mund të jenë të dobishme për të gjitha palët e interesuara për të krijuar një mjedis të favorshëm për median. Sipas raporteve të organizatave vendore dhe ndërkombëtare përkatëse, mjaft raste janë raportuar gjatë kësaj krize shëndetësore ku masat kanë vënë në rrezik lirinë e medias dhe lirinë e shprehjes në rajonin e OSBE-së.

Muajt e fundit, me kufizimet dhe mbylljet e shkaktuara prej COVID-19, media ka asistuar në një rritje të kërkesës së publikut për informacion, por edhe pengesa më të mëdha për të qasur të dhëna të besueshme që zotërojnë autoritetet publike. Njëkohësisht, kriza shëndetësore ka shkaktuar efekt ekonomik negativ te sektori i medias, i pasqyruar në rënie drastike të tirazhit dhe të të ardhurave prej reklamave.

- **Mogens Blicher Bjerregård**, Kryetar, Federata Evropiane e Gazetarëve
- **Saša Mirković**, Pedagog, Universiteti Singidunum, Shkolla për Median dhe Komunikimin, Serbi
- **Marina Tuneva**, Drejtore Ekzekutive e Këshillit të Etikës së Medias, Maqedonia e Veriut
- **Moderator: Borka Rudić**, Sekretare e Përgjithshme, Shoqata e Gazetarëve të Bosnjë-Hercegovinës

11:30 Pushim për kafe: Shfaqja e videove me histori nga gazetarët vendorë, përparitur nga Fondacioni SlavkoČuruvija

12:00 Sesion Paneli IV: Përpjekjet për t'u Mbyllur Gojën Gazetareve – Nga Portretizimi te Ngacmimi Online

Gazetarët po përballen me kërcënime, ngacmime dhe frikësime me bazë gjinore, sidomos në internet. Kjo jo vetëm ndikon drejtëpërdrejtë te siguria e tyre individuale, por rrezikon të krijojë një efekt frenues te veprimtaria e tyre gazetareske dhe pjesëmarrja në debatet publike, duke cenuar qasjen e sigurisë në një pluralitet zërash dhe informacionesh. Në këtë sesion paneli, gazetarët dhe institucionet shtetërore do të trajtojnë masat e Shteteve pjesëmarrëse ndaj këtij shqetësimi në rritje. Gjithashtu, do të prezantohen dhe do të diskutohen masa konkrete për të kaluar nga politikatat te zbatimi në praktikë, sidomos në kuadrin e Udhëzuesit të Burimeve RFoM #SOFJO që do të publikohet në vjeshtë 2020.

Vendimi historik i Këshillit Ministror të OSBE-së për Sigurinë e Gazetarëve shpreh shqetësim specifik për "rreziqet e caktuara me të cilat përballen gazetarët në punën e tyre, edhepërmjet teknologjive dixhitale" dhe pranon që sulmet vijnë në shumë forma, "si ngacmim seksual, abuzim, frikësim, kërcënime dhe dhunë, edhepërmjet teknologjive dixhitale". Vendimi thekson rëndësinë e adresimit në mënyrë efektive të këtyre sulmeve dhe kërcënimeve nga ana e qeverive dhe autoriteteve ligjzbatuese. Gjithashtu, Komunikata për Pluralizmin e Medias, Sigurinë e Gazetareve dhe Mbrotjen e Zërave të Marxhinalizuar Online (PLeM) rekomandon që Shtetet pjesëmarrëse të mundësojnë dialog shumëpalësht të rregulltqë përfshin të gjitha palët e interesuara, për të garantuar një përgjigje holistike dhe sistematike ndaj ngacmimit online të gazetareve, si edhe për të nxitur zhvillimin e përgjigjeve novatore ndaj ngacmimit online në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Dëshmi: Raportimi i lajmit në mes të pandemisë COVID-19

- **Ana Lalić**, Gazetare, nova.rs
- **Nidždara Ahmetašević**, Gazetare e pavarur

Panelistë

- **Vanja Čalović Marković**, Drejtore, Rrjeti për Afirmimin e Sektorit të OJF-ve, Mali i Zi
- **Gentiana Begolli-Pustina**, Kryetare e Bordit të AJK-së
- **Moderator: Silvia Chocarro**, Kryetare e Mbrotjesve të Gazetarëve dhe të Të Drejtave të Njeriut, ARTICLE19

13:00 Fjala përmbyllëse

- **Jürgen Heissel**, Drejtor, Zyra e Përfaqësuesit të OSBE-së për Lirinë e Medias
- **Gordana Janković**, Shefe e Departamentit të Medias, Misioni i OSBE-së në Serbi

13:30 Mbyllet Dita II